

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“SHQIPONJA SECURITY” SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më datë 24.07.2024, ne të nënshkruarit:

1. **Arlind Boshku** i datëlindjes 07.07.1985, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi I50707073E
2. **Neritan Golja** i datëlindjes 17.08.1973, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi H30817087M

themelojme një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:

“SHQIPONJA SECURITY SHPK.

Shoqëria rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Neni 2: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë:

Durres, Lagjia 11, Rruga “Deshmoreve”, Zona Kadastrale 8513, Godine me Nr.pasurie 7/480

Shoqëria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

Ruajtja dhe sigurimi fizik i objekteve shtetërore dhe private ne pronesi ose ne përdorim të personave fizik ose juridik, që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, si dhe veprimtarive social-kulturale, sportive, fetare e politike. Sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe të shëndetit të shtetasve.

Shoqëria do të kryej shërbime të kategorisë 1.3.A sipas Ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 "Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr.538 datë 26.05.2009 "Për kategorinë e këtij shërbimi". Shoqëria për shërbimin e sigurimit privat sipas nenit 32 të ligjit 75/2014 datë 10.07.2014 është e detyruar të përdorë mjete dhe pajisje elektronike në veprimtarinë e sigurisë fizike. Për realizimin e objektit të përcaktuar në nenin 2 pika a, shoqëria ka të drejtë të përdorë armët e zjarrit sipas ligjit, në shërbim, si dhe të marrë masat përkatëse për parandalimin e pasojave që mund të sjellë ky lloj shërbimi.

Tregtimin, Importin, eksportin të sistemeve të alarmit, kamerave të ndryshme, pajisjeve të ndryshme elektronike, veturave apo automjeteve me fuqi të vogël motorike edhe automjeteve elektrike . Dhënia me qira tek të tretët të të gjitha llojeve të automjeteve. Tregtimin e mallrave e pajisjeve dhe instalimin e mjeteve të sistemit vrojtues, sinjalizues, audioviziv, mjeteve të mbrojtjes kundër zjarrit, dhe shërbimeve të tjera të ngjashme.

Shoqëria do të kryej shërbime të kategorisë 1.3.B Shërbime të ruajtjes, transportimit dhe shoqërimi i vlerave monetare dhe sendeve të çmuara.

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100.000 lekë, i ndarë në 2 kuota. Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Arlind Boshku është zotërues i 1 kuote, me vlerë 50.000 lekë, me 50 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.

Neritan Golja është zotërues i 1 kuote, me vlerë 50.000 lekë, me 50 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- (-) Asambleja e Përgjithshme.
- (-) Administrator i shoqërisë do të jete **Z. Arlind Boshku** për një periudhë 5 - vjeçare me të drejtë riemërimi.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.


Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakeve të Shoqërisë

Arlind Boshku

Arlind Boshku


Neritan Golja

Neritan Golja
